

6.2 SHTIMI I REGJISTRIMEVE NË KUJTESËN E FRAGMENTEVE

Nga dritarja për kërkim në kujtesën e fragmenteve mund të shtoni një ose më shumë regjistrime, variantet e ndryshme të regjistrimeve për burimin e njëjtë bibliografik dhe regjistrimet e ruajtura përkohësisht.

6.2.1 Shtimi i regjistrimeve nga dritarja për kërkim

Në kujtesën e fragmenteve regjistrimet mund t'i shtoni duke aktivizuar dritaren për kërkim në baza të ndryshme të të dhënave (p.sh. në bazën lokale të të dhënave, në COBIB, në bazën e të dhënave CONOR dhe SGC, në bazën e të dhënave CORES, në baza të tjera të përbashkëta bibliografike në rrjetin COBISS.Net ose baza të tjera të huaja të të dhënave (Katalogu online i Bibliotekës së Kongresit, WorldCat, ISSN)).

Procedura

1. Përzgjidhni metodën **Kërkimi / <akronimi i bazës së të dhënave>** (p.sh. **Kërkimi / CONOR**).
Hapet dritarja **Kërkimi – <...>** (p.sh. **Kërkimi - Regjistrimi i njësuar CONOR**).
2. Shënoni pyetjen e duhur për kërkim dhe ekzekutojeni kërkimin. Procedura e kërkimit është përshkruar në kap. 4.
Regjistrimi, të cilin e kërkoni, ndodhet midis rezultateve të kërkimit. Mund të gjeni disa regjistrime.
3. Përzgjidhni regjistrimin e duhur, apo disa regjistrime në listën e rezultateve të kërkimit dhe klikoni butonin **Përzgjidh**.
Regjistrimi, të cilin e keni përzgjedhur, shtohet si skedë në kujtesën e fragmenteve të regjistrimeve.

6.2.1.1 Regjistrimet e redaktuara në COBIB

Në bazën lokale të të dhënave mund të gjeni regjistrimet e redaktuara në COBIB dhe sipas nevojës i përditësoni ato.

Procedura

1. Përzgjidhni metodën **Kërkimi / Regjistrimet e redaktuara në COBIB**.
Hapet dritarja **Kërkimi – Regjistrimet e redaktuara në COBIB**.
2. Shënoni pyetjen për kërkim dhe ekzekutoni kërkimin.

Hapet dritarja **Regjistrimet e redaktuara në COBIB** në të cilën ndodhen vetëm regjistrimet, të cilat pas ruajtjes në bazën tuaj lokale janë redaktuar në bazën e përbashkët.

- Regjistrimet i kontrolloni dhe i përzgjidhni ato që dëshironi t'i përditësoni. Regjistrimet e përzgjedhura ngarkohen në kujtesën e fragmenteve. Përmes metodës **Regjistrimi / Redakto regjistrimin** përditësimet nga COBIB-i ruhen edhe në bazën tuaj lokale.



Shënim:

Kërkimi i regjistrimeve të redaktuara është i kufizuar në 5.000 regjistrime. Rekomandohet klasifikimi i kërkimit në pjesë më të vogla; p.sh. shënohet periudha disa muajshe ose vitesh (varësisht nga madhësia e bazës lokale) e krijimit të regjistrimeve.

Mundësitë...

Regjistrimet e redaktuara në COBIB mund t'i gjeni edhe përmes metodës **Regjistrimi bibliografik / Regjistrimet e redaktuara në COBIB** në shfletues.

6.2.2 Shtimi i regjistrimit për burimin e njëjtë bibliografik

Regjistrimit të përzgjedhur në kujtesën e fragmenteve ose regjistrimit në redaktues mund t'i shtoni variantin përkatës nga baza lokale e të dhënave, përkatësisht COBIB-i. Në këtë mënyrë mund të krahasoni variante të ndryshme të regjistrimit për të njëjtin burim bibliografik.

6.2.2.1 Varianti i regjistrimit nga COBIB-i

Regjistrimit në kujtesën e fragmenteve ose regjistrimit në redaktues mund t'i shtoni variantin e regjistrimit nga COBIB-i, pa pasur nevojë të aktivizoni dritaren për kërkim.

Procedura

- Gjeni dhe përzgjidhni regjistrimin.
- Përzgjidhni metodën **Kujtesa e fragmenteve / Shfaq variantin e regjistrimit nga COBIB-i**.

Në kujtesën e fragmenteve të regjistrimeve shtohet regjistrimi përkatës nga COBIB-i.



Shënim:

Nëse në COBIB nuk ndodhet regjistrimi përkatës, programi ju paralajmëron.

6.2.2.2 Varianti i regjistrimit nga baza lokale e të dhënave

Regjistrimit në kujtesën e fragmenteve ose regjistrimit në redaktues mund t'i shtoni variantin e regjistrimit nga baza lokale e të dhënave, pa pasur nevojë të aktivizoni dritaren për kërkim.

Procedura

1. Gjeni dhe përzgjidhni regjistrimin.
2. Përzgjidhni metodën **Kujtesa e fragmenteve / Shfaq variantin e regjistrimit nga baza lokale e të dhënave**.

Në kujtesën e fragmenteve të regjistrimeve shtohet regjistrimi përkatës nga baza lokale e të dhënave.



Shënim:

Nëse në bazën lokale nuk ndodhet regjistrimi përkatës, programi ju paralajmëron.

6.2.2.3 Varianti fillestar i regjistrimit

Regjistrimit në redaktues mund t'i shtoni në kujtesën e fragmenteve gjendjen e regjistrimit para fillimit të redaktimit. Varianti fillestar i regjistrimit nuk përputhet detyrimisht me gjendjen e ruajtur në bazën e të dhënave dhe atë mund ta kontrolloni vetëm deri sa regjistrimin në redaktues nuk e ruani.

Parakusht

Regjistrimi duhet të jetë në redaktues.

Procedura

1. Përzgjidhni metodën **Kërkimi / Shfaq regjistrimin fillestar**.

Në kujtesën e fragmenteve të regjistrimeve shtohet regjistrimi fillestar. Ky regjistrim përputhet me regjistrimin i cili para redaktimit është ngarkuar në redaktues (gjendja e regjistrimit para përditësimit).



Shënim:

*Nëse në redaktues jeni duke krijuar një regjistrim të ri, metoda **Kërkimi / Shfaq regjistrimin fillestar** nuk është aktive.*

6.2.3 Shtimi i regjistrimit të ruajtur përkohësisht

Në kujtesën e fragmenteve të regjistrimeve mund të shtoni edhe regjistrimin e ruajtur përkohësisht (shih kap. 11.1 dhe kap. 11.2).

Procedura

1. Përzgjidhni metodën **Kërkimi / Regjistrimet e ruajtura përkohësisht**.
Hapet dritarja **Regjistrimet e ruajtura përkohësisht**.

2. Gjeni dhe përzgjidhni regjistrimin (shih kap. 11.3)

Në kujtesën e fragmenteve të regjistrimeve shtohet regjistrimi i ruajtur përkohësisht.